



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
GJYKATA E SHKALLËS SË PARË  
PËR KRIME TË RËNDA

NR. AKTI 8  
28.03.2014

NR. VENDIMI 4  
01.04.2014

**V E N D I M**  
**per**  
**“SEKUESTRIMIN E PASURISE “**

Gjykata e Shkallës së Parë për Krimet e Rënda Tiranë, me trup gjykues të përbërë nga :

**Gjyqtar : Nertina KOSOVA**

Asistuar prej sekretares gjyqësore **Blerina Sukaj** sot, ditën e martë, më dt.**01.04.2014, ora14.00**, mori ne shqyrtim ne séance gjyqësore jo publike kerkesen penale nr.08 me:

**KERKUES:** Prokuroria Prane Gjykates se Shkalles se Pare per Krime te Renda - Tirane, perfaqesuar nga prokurori Ened Nakuci.

**KUNDER:** Shtetasve nen hetim: **-R.F.**, i biri i V. dhe i N., i datëlindjes xxx, lindur dhe banues në fshatin xxx, bashkia xxx, xxx.

**-R.F.**, i biri i R. dhe i Xh., i datëlindjes xxx lindur dhe banues në fshatin xxx, bashkia xxx, xxx.

**-K. (B.) B.(F.)** i i R. dhe i Xh., i datëlindjes xxx lindur dhe banues në fshatin xxx, bashkia xxx, xxx.

**OBJEKTI:** “Sekuestrim pasurie”

**BAZA LIGJORE:** Ligji nr. 10192 datë 03.12.2009 “Per parandalimin

dhe Goditjen e Krimit te Organizuar dhe Trafikimit  
Nëpërmjet Masave Parandaluese kundër Pasurisë”,

Në përfundim të shqyrtimit gjyqësor të zhvilluar në prani të prokurorit Ened Nakuci që kërkoi pranimin e kërkesës e konkretisht :

*I - « Sekuestrimin e shumës në depozitën me gjendje xxx lekë në ‘xxx’ që i përkasin shtetasit R.V.F.*

*II- Për Administrimin dhe përdorimin e pasurive të luajtshme të ngarkohet z.K.Xh., administrator i Agjencisë për Administrimin e pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara pranë Ministrisë së Financave Tiranë.*

*I. Për ekzekutimin e këtij vendimi të ngarkohet Zyra e Përmbarimit xxx.*

Gjykata si mori në shqyrtim aktet e provat e paraqitura;

**VËREN SE:**

Me datë xxx në sekretarinë e kësaj Gjykate është depozituar për gjykim kërkesa penale e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë, me objektin lartpërmendur mbi procedimin pasuror nr x datë xxx.

Rezulton se Prokuroria për Krime të Rënda Tiranë në funksion të procedimit penal nr. xx të regjistruar me datë xxx, ceshtje e cila është në hetim pranë Prokurorisë së xxx, mbi bazën e materialit të referuar nga Oficerët e Policisë Gjyqësore të Sektorit të Hetimit të Aseteve Kriminale në Drejtorinë e Policisë së Qarkut Durrës në dt. xxx, si të dyshuar, për veprën penale të “Pastrimit të produkteve të veprës penale” në ngarkim të shtetasve R.F., R.F.

Mbi bazën e kërkesës së paraqitur nga Prokuroria për Krime të Rënda Tiranë, kjo gjykatë me vendimin e saj nr. x datë xxx ka vendosur ndër të tjera edhe “-Sekuestrimin e depozitës bankare e gjendur në xxx bank, në shumën xxx lekë në emër të shtetasit R.V.F. ndaj së cilës është vendosur sekuestro preventive...”

Me vendimin Nr xx datë xxx të Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda është vendosur :”Lënien në fuqi të vendimit Nr xx datë xxx të Gjykatës së Shkallës së parë për Krime të Rënda Tiranë. Pezullimin e ekzekutimit të

pasojave të zbatimit të masës së sekuestros (kësaj) mase sipas ligjit nr 10192 datë 03.12.2009 për pasuritë e sekuestruara me vendimin nr xxx datë xxx të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor xxx, ndër të cilat bëhet fjalë dhe për Depozitën bankare te gjendur ne xxx bank, në shumën **xxx (xxx) lekë** në emër të shtetasit R.V.F..

Vendimi i sipërcituar, sipas shkresave dërguar nga Agjensia për Administrimin e Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara, nr Prot xxx datë xxx, behet me dije Prokuroria për Krime të Rënda dhe kjo Gjykatë, se ka qene e pamundur të ekzekutohet ky vendim për të vendosur sekuestron ndaj kësaj shume për shkak se kjo shumë qe transferuar në një Bankë tjetër, në datë xxx dhe xxx.

Mbi baze të këtyre akteve, nga prokurori, është kërkuar informacion në lidhje me lëvizjet e kësaj depozite, të kryera para se të kërkohej fillimisht sekuestro për këtë shumë nga prokurori në gjykatë, dhe me shkresën nr xxx datë xxx të "xxx Bank" bëhet me dije se shuma prej **xxx (xxx) lekë** është investuar në llogarinë e xxx pranë "xxx" si dhe këto kuota nuk janë tjetërsuar dhe janë në pronësi të z. R.F. Në këtë shkresë pasqyrohet dhe fakti se xxx është person juridik i ndryshëm nga xxx Bank sh.a.

***Pra kjo sasi vlere monetare në shumën xxx (xxx) lekë, në emër të Reshit Farruku, nuk ndodhet ne cilësinë e depozitës bankare, por është një "zë" investim për blerje të kuotave dhe e transferuar në xxx pranë "xxx", në emër të të njëjtit person.***

***Ndodhur në këto kushte nga prokurori kërkohet vendosja e sekuestros se kësaj shume monetare e investuar në kuota pranë Bankës lartpërmendur.***

Nga kërkuesi, përfaqësuesi i Prokurorisë për Krime të Rënda, u shpreh se kushtet për vendosjen e kësaj sekuestroje vijojnë të ekzistojnë, porse duke u saktësuar forma dhe vendi ku ndodhet kjo shumë prej **xxx (xxx) lekë në emër të Reshit Farruku**, me qëllim sekuestrimin e saj ***në xxx pranë "xxx", e nga prokurori u deklarua se pavaresisht "Sekuestro-s Preventive" vendosur me vendimin nr.xxx datë xxx të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor xxx, ka patur transferim te tyre ne vitin xxx, ndaj eshte e domosdoshme venia e sekuestros sipas Ligjit nr 10192.***

Prokurori argumenton se te hetuarit R.e R.F., bazuar ne nenin 3/1/d të

Ligjit nr. 10192 datë 03.12.2009, vijojne të jenë subjekte tëketij ligji mbështetur në nenin 287 të K.Penal, ndaj dhe pasuria e evidentuar, e cila nuk është me "depozite bankare", sikunder është shprehur Gjykata për Krime të Rënda ne vendimin e saj nr x date xxx, apo Gjykata e Rrethit Gjyqësor xxx ne vendimin nr xxx datë xxx duke vendosur sekuestro preventive, pasi fakti se kjo shume e vlere monetare është transferuar në një Banke tjetër në forme "kuotash" te xxx, e vijon të jetë ne emer te te hetuarit R.F., nga kjo gjykatë cmohet se duhet ti nënshtrohet procedurës së sekuestrimit sipas ligjit te mesiperme, konform nenit 3/1/ "ç" te Ligjit 10192 datë 03.12.2009 "Per parandalimin dhe Goditjen e Krimit te Organizuar dhe Trafikimit Nëpërmjet Masave Parandaluese kundër Pasurisë" e ne kushtet kur janë gjetur elementët që përmbushin kriteret e ligjit të posacëm. Pikërisht për këtë arsye prokurori pretendon e argumenton se ekziston rreziku real dhe potencial që shuma monetare e mesiperme e ndodhur ne nje tjetër Banke dhe jo në atë të shprehur ne vendimin e saj te gjykatës nr xxx datë xxx, mund te tjetërsohen, apo te humbasin, prandaj ne baze te nenit 11/1 te ligjit te sipercituar , duhet te sekuestrohet ne perputhje me nenin 3/1 germat "d"e"ç" te ligjit nr. 10192 datë 03.12.2009 **"Per parandalimin dhe Goditjen e Krimit te Organizuar dhe Trafikimit Nëpërmjet Masave Parandaluese kundër Pasurisë", pikërisht ku ndodhet kjo shume që vijon të jetë në emër e pronësi të R.F.**

Nga Gjykata cmohet se kjo kerkese eshte e bazuar ne ligj dhe ne prova e si e tille duhet te pranohet.

Gjykata si degjoi pretendimet e prokurorit dhe shqyrtoi provat e mesiperme konkludon se, ne baze te nenit 3/1/"d"e "ç" te ligjit nr. 10192 datë 03.12.2009 "Per parandalimin dhe Goditjen e Krimit te Organizuar dhe Trafikimit Nëpërmjet Masave Parandaluese kundër Pasurisë", meqenëse të hetuarit në këtë procedim pasuror janë subjekte të ligjit parandalues pasi per ta ka dyshime te arsyeshme te mbeshtetura ne prova e indicje te plota se kanë konsumuar elemente te vepres penale te "Trafikimit te narkotikeve" ne bashkepunim (shtetasi K.F.), parashikuar nga neni 283/a/2 te K.Penal si dhe ndaj shtetasve R. e R.F. dyshohet se janë konsumuar elemente të veprës penale të "Pastrimit të produkteve të krimit"parashikuar nga neni 287 të K.Penal, sikunder kjo gjykatë është shprehur e ka argumentuar në vendimin e saj nr xx datë xxx. Per me teper meqenëse prokurori pretendon e argumenton se ekziston rreziku real dhe potencial që pasurite e mesiperme te tjetërsohen, apo te humbasin, ne baze te nenit 11/1 te ligjit te sipercituar ato duhet te sekuestrohen ne perputhje me nenin 3/1 germat "d"e"ç" te ligjit nr. 10192 datë 03.12.2009 **"Per parandalimin dhe Goditjen e Krimit te Organizuar dhe**

## **Trafikimit NËpërmjet Masave Parandaluese kundër Pasurisë”.**

Gjykata bazuar ne nenin 5 te ligjit parandalues vlereson se kerkesa e prokurorit dhe procedura e sekuestrimit te pasurive sipas ligjit parandalues, nuk varen nga gjendja e shkalla e procedimit penal.

Gjykata vlerëson, gjithashtu, se bazuar në ligjin 10 192 datë 03.12.2009, masat parandaluese ndaj pasurisë së të hetuarve, për përfshirjen në veprimtarinë e mësipërme kriminale, duhet te vendosen pavaresisht faktit se me pare per keto shuma monetare e pasuri të paluajtshme, eshte vendosur sekuestro ne funksion te procedimit penal, meqenese per keto shuma monetare ekziston një rrezik real dhe potencial që pasuria e luajtshme, shumat monetare apo pronat e paluajtshme lartpërmendur te tjetërsohen, apo te humbasë (neni 11/1, pikat “a”e ‘b’), ne rast te shfuqizimit te sekuestrimit(*megjithese eshte fakt se per kete shume monetare ajo është tjetërsuar në forme kuotash për investim ne datat xxx dhe xxx, ne llogarine e xxx e qe vijojnë të jenë në emër të të hetuarit R.F., pra nuk janë ne zërin ‘Depozitë Bankare’ e flet qartë se nuk është nën efektet e vendimit nr xxx të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor xxx, për sekuestron preventive*), vendosur ne funksion te procedimit penal ndaj bazuar në nenet; 3 deri në 7, 11, 12, 14 dhe 15 e vijues të ligjit nr. 10192 datë 03.12.2009 “Per parandalimin dhe Goditjen e Krimit te Organizuar dhe Trafikimit NËpërmjet Masave Parandaluese kundër Pasurisë” si e tille kjo kerkese duhet te pranohet duke u vendosur masa e sekuestrimit.

Pra sa me lart, Gjykata, referuar dhe vendimit te saj nr x datë xxx, meqenese ndryshon vetem vendndodhja/”zëri”i shumes monetare prej xxx (xxx) lekë, jo “*depozitë bankare*” por e investuar në llogarinë e xxx pranë ‘xxx’ si dhe këto kuota janë ende në pronësi të z. R.F., sipas nenit 3 të Ligjit 10192 date 03.12.2009, ne keto kushte Gjykata vlereson si te drejte dhe te bazuar ne ligj kerkesen e Prokurorise per Krime te Renda Tirane.

*Ne baze te provave te marra e shqyrtuara ne seance gjyqesore, gjykata vlereson se kerkesa e akuzes per sekuestrimin e pasurise se evidentuar(shumës monetare në vlerën e sipërcituar) ne pronesi te hetuarit R.F. eshte e drejte e duhet te pranohet.*

Mbështetur ne nenin 11/1/a te ligjit nr. 10192 datë 03.12.2009 “Per parandalimin dhe Goditjen e Krimit te Organizuar dhe Trafikimit NËpërmjet Masave Parandaluese kundër Pasurisë” qe parashikon se “ *Me kërkesë të motivuar të prokurorit, gjykata vendos sekuestrimin e pasurive të personave,*

*sipas nenit 3 të këtij ligji, kur ekziston një dyshim i arsyeshëm, i bazuar në indicie që tregojnë se personi mund të jetë i përfshirë në veprimtari kriminale dhe zotëron pasuri apo të ardhura, që nuk i përgjigjen dukshëm nivelit të të ardhurave, fitimeve apo veprimtarive të ligjshme, të deklaruara dhe as nuk justifikohen prej tyre dhe kur:*

*a) ekziston një rrezik real për humbje, marrje apo tjetërsim të fondeve, pasurive apo të drejtave të tjera, mbi të cilat parashikohet vënia në zbatim e masës së konfiskimit, sipas dispozitave të këtij ligji;*

*b) ka dyshime të arsyeshme që tregojnë se zotërimi i pasurive dhe ushtrimi i veprimtarive të caktuara ekonomike, tregtare dhe profesionale janë në gjendje rreziku apo ndikimi nga ana e një organizate kriminale ose që mund të lehtësojnë veprimtaritë kriminale.’’, kjo kërkesë e prokurorit duhet pranuar.*

Gjykata, nisur edhe nga **“ndryshimi në zë”** i kësaj shume monetare në emër e pronësi të R.F., mbi bazen e provave të shqyrtuara, vlerëson se ekziston rreziku real për tjetërsimin e kësaj pasurie që kërkohej të sekuestrohet, e që disponohet në emër të hetuarit/paditurve apo të afërm të tyre, rrethane kjo e parashikuar nga neni 11/1 pika a e ligjit nr 10192 datë 03.09.2009 prandaj me qëllim ruajtjen e tyre është e domosdoshme që për keto pasuri duhet të vendoset masa e sekuestros, bazuar në këto ligj e në kushtet kur kërkesa gjendet e drejte dhe plotësohen kriteret e parashikuara në këto ligj.

Gjykata vlerëson, gjithashtu, se bazuar në ligjin 10 192 datë 03.12.2009, kjo masë parandaluese ndaj pasurisë së të hetuarve, për përfshirjen në veprimtarinë e mësipërme kriminale, duhet të vendoset menjëherë, meqenese ekziston një rrezik real dhe potencial që pasuria e luajshme, shumat monetare apo pronat e paluajshme lartpërmendur të tjetërsohen, apo të humbasë (neni 11/1, pikat “a” e “b”), e bazuar në nenet; 3 deri në 7, 11, 12, 14 dhe 15 e vijues të ligjit nr. 10192 datë 03.12.2009 **“Per parandalimin dhe Goditjen e Kriminimit të Organizuar dhe Trafikimit Nëpërmjet Masave Parandaluese kundër Pasurisë”** si e tillë kjo kërkesë duhet të pranohet.

Gjykata urdheron sekretarinë gjyqësore të kryejë veprimet e njoftimit sipas nenit 130 të K.Pr.Civile Institucioneve përkatëse e paleve të interesuara.

Për ekzekutimin e këtij vendimi mbështetur në nenin 14 të ligjit nr 10192 datë 03.09.2009 urdherohet Zyra e Permbarrimit Gjyqësor xxx, pasi Qendra e personit juridik, xxx e xxx, ndodhet në xxx, ndërsa për administrimin e kësaj pasurie të ngarkohet z.K.Xh., i cili është administrator pranë Agjensisë për Administrimin e pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara pranë Ministrisë së Financave Tirane.

**PER KETO ARSYE**

Gjykata ne baze te neneve 212 e vijues te K.Pr.Civile nenet 3/1/ç; 3/4; 5; 7; 11/1/a, 12,14,15 e vijues te ligjit nr. 10192 datë 03.12.2009 “Per parandalimin dhe Goditjen e Krimit te Organizuar dhe Trafikimit Nëpërmjet Masave Parandaluese kundër Pasurisë”

## V E N D O S I

-Pranimin e kerkeses se Prokurorise per Krime te Renda Tirane duke urdheruar:

”-*Sekuestrimin e shumës prej xxx (xxx) lekë, të investuar në llogarinë e xxx pranë ‘xxx’ në emër e pronësi të z. R.F.’.*”

-Per ekzekutimin e ketij vendimi ngarkohet Zyra e Permbarimit Gjyqesor, xxx.

-Per Administrimin e kesaj pasurie ngarkohet z. K.Xh., i cili eshte administrator prane Agjensise per Administrimin e pasurive te Sekuestruara dhe te Konfiskuara prane Ministrise se Financave Tirane.

-Urdherohet sekretaria Gjyqesore e kesaj Gjykate te dergoje menjehere **kopje te ketij vendimi ne Institucionet e siperme si dhe të njoftohen palët e interesuara për këtë vendim.**

- Kunder vendimit lejohet te behet ankim brenda afatit te parashikuar ne K.Pr.Civile ne Gjykatën e Apelit per Krimet e Renda Tirane.

U shpall ne Tirane sot me dt. 01.04.2014 ora 14.20.

**SEKRETARE**

**GJYQTARE**

**Blerina SUKAJ**

**Nertina KOSOVA**